



REPUBLIKË SË SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 849 Prot.

Tiranë, më 19.06 2017

VENDIM Nr. 124, datë 05.06.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.9, datë 05.06.2017, pasi shqyrtoi Kërkesën për miratim të *projektit "Rikonstruksion i një vile individuale ekzistuese 2 kat me ndryshim funksioni nga ajo ekzistuese dhe shtesë dy kat me funksion banim"*, në lagjen Nr. 6, Rruga "Kasem Durrësi" Nr. 5, zhvillues Z. Rifat Aliu ", në zonën arkeologjike "B" Durrës,

VENDOSI:

1. Të miratojë *projektin "Rikonstruksion i një vile individuale ekzistuese 2 kat me ndryshim funksioni nga ajo ekzistuese dhe shtesë dy kat me funksion banim"*, në lagjen Nr. 6, Rruga "Kasem Durrësi" Nr. 5, zhvillues Z. Rifat Aliu ", në zonën arkeologjike "B" Durrës, duke plotësuar përcaktimin e pikës 2 të këtij vendimi.
2. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me individ të licencuar në arkeologji, i cili duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit, për ndërtimin *"Rikonstruksion i një vile individuale ekzistuese 2 kat me ndryshim funksioni nga ajo ekzistuese dhe shtesë dy kat me funksion banim"*, në lagjen Nr. 6, Rruga "Kasem Durrësi", si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al